

VENDIM
Nr. 454, datë 10.6.2020

PËR DISPOZITAT ZBATUESE TË LIGJIT NR. 72/2019, “PËR MASAT SHTRËNGUESE NDËRKOMBËTARE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 100, të Kushtetutës, të neneve 6, pika 8, 10, pika 6, 15, pika 5, të ligjit nr. 72/2019, “Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, me propozimin e Kryeministrit dhe ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. PROCEDURAT PËR BLOKIMIN E PËRKOHSHËM

1. Ministria përgjegjëse për punët e jashtme, në vijim Ministria, me marrjen e njoftimit për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese të vendosura, sipas shkronjave “b”, “c” dhe “ç”, të pikës 3, të nenit 3, të ligjit nr. 72/2019, “Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, në vijim ligji nr. 72/2019, njofton menjëherë organet përgjegjëse.

2. Njoftimi i bëhet pikave të kontaktit, të caktuara nga organet përgjegjëse, nëpërmjet postës zyrtare elektronike.

3. Me marrjen e njoftimit, organet përgjegjëse marrin menjëherë masat për bllokimin e përkohshëm të aseteve që ndodhen në territorin e Republikës së Shqipërisë, deri në miratimin e vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave.

4. Me marrjen e njoftimit për vendosjen, zbatimin, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, organet përgjegjëse, organet publike, si dhe çdo person, fizik ose juridik, në Republikën e Shqipërisë, janë të detyruara që të zbatojnë menjëherë dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë, pa e kushtëzuar procesin me miratimin e akteve të mëtejshme nënligjore brenda vendit, bllokimin e përkohshëm të çdo veprimi, ndërmjetësimi, transaksioni, transferete, shërbimi financiar apo të tjera të lidhura, fonde dhe pasuri të tjera.

5. Ministri përgjegjës për punët e jashtme, brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja dijeni e vendosjes, ndryshimit apo shfuqizimit të masës shtrënguese në rastet e akteve të detyrueshme të miratuara nga organizata ndërkombëtare dhe rekomandimit të Komitetit të Masave Shtrënguese Ndërkombëtare për aktet të Bashkimit Evropian, i propozon Këshillit të Ministrave masën shtrënguese ndërkombëtare dhe subjektin ndaj të cilit vendoset kjo masë.

II. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I KOMITETIT TË MASAVE SHTRËNGUESE NDËRKOMBËTARE

1. Komiteti i Masave Shtrënguese Ndërkombëtare, në vijim Komiteti, drejtohet nga ministri përgjegjës për punët e jashtme dhe, në mungesë të tij, nga zëvendësministri i deleguar prej tij.

2. Komiteti mbledhet, si më poshtë vijon:

2.1. Me kërkesë të ministrisë për të shqyrtuar:

a) kërkesën e organit përgjegjës drejtuar ministrisë, për rastet kur ky i fundit do të propozojë ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare me karakter të brendshëm. Kërkesa e organit përgjegjës drejtuar ministrisë duhet të jetë në përputhje me parashikimet e nenit 9, të ligjit nr. 72/2019.

b) njoftimet për masat shtrënguese të vendosura në bazë të:

i. akteve të detyrueshme, të miratuara nga organizatat ndërkombëtare, ku Republika e Shqipërisë është shtet anëtar, duke përjashtuar masat shtrënguese të vendosura nga OKB-ja;

ii. akteve të Bashkimit Evropian.

2.2 Me iniciativën e tij, për të përmbushur detyrat e përcaktuara në shkronjat “b”, “c”, “ç” dhe “d”, të pikës 2, të nenit 10, të ligjit nr. 72/2019.

3. Komiteti mbledhet pas marrjes së njoftimit, me shkrim, nga ministria. Njoftimi përmban rendin e ditës së mbledhjes, orën dhe datën, e cila duhet të jetë brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e njoftimit.

4. Përveç rasteve kur mbledhja e Komitetit nuk ka objekt dhënien e rekomandimeve, Komiteti merr vendim për të dalë me një rekomandim, i cili do të nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e tij.

5. Titullari i ministrisë ngarkon një nëpunës të strukturës përkatëse për organizatat ndërkombëtare si “pikë kontakti” për zbatimin e masave shtrënguese, sipas ligjit nr. 72/2019, i cili do të marrë pjesë në çdo mbledhje të Komitetit.

6. Me autorizim të ministrit përgjegjës për punët e jashtme, Komiteti mund të asistohet edhe nga një nëpunës i strukturës përkatëse që mbulon organizatën, e cila ka njoftuar për vendosjen ndryshimin dhe shfuqizimin e masës shtrënguese ndërkombëtare, si dhe një nëpunës nga struktura që do të përgatisë paketën ligjore për miratim në Këshillin e Ministrave të vendimit për vendosjen, ndryshimin ose shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare.

7. Dokumentacioni dhe materialet e përdorura për mbledhjet e Komitetit arkivohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për arkivat.

III. KRIJIMI, PËRMBAJTJA, RREGULLAT E ADMINISTRIMIT E TË FUNKSIONIMIT, TË PËRDORIMIT DHE TË AKSESIMIT TË REGJISTRIT TË TË DHËNAVE PËR MASAT SHTRËNGUESE NDËRKOMBËTARE

1. Në ministri krijohet regjistri elektronik i bazës Të të dhënave për masat shtrënguese ndërkombëtare.

2. Regjistri mbahet, ruhet, administrohet dhe përditësohet në formë elektronike nëpërmjet një sistemi kompjuterik nga nëpunësi i ngarkuar me autorizim të titullarit të ministrisë.

3. Regjistri përmban të dhëna të mbledhura nga burime autentike të krijimit të të dhënave nga ministria, si dhe të dhënat e ofruara nga organet përgjegjëse për:

- a) subjektet të cilave u vendosen masa shtrënguese ndërkombëtare;
- b) subjektet që shkelin zbatimin e masave shtrënguese, të vendosura sipas ligjit nr. 72/2019.
- c) vendimet e gjykatës, nëse ka të tilla;
- ç) kuadrin e masave shtrënguese ndërkombëtare.

4. Regjistrohen si të dhëna parësore në këtë bazë të dhënash elementet, si më poshtë vijon:

- a) Autoriteti, i cili ka vendosur masën shtrënguese ndërkombëtare;
- b) Parashtrimi i përmbledhur i rrethanave të faktit;
- c) Arsyet për shkak të të cilave është vendosur masa shtrënguese ndërkombëtare;
- ç) Dispozitivi i vendimit;
- d) Data dhe vendi i marrjes së vendimit.

5. Regjistrohen si të dhëna dytësore në këtë bazë të dhënash:

- a) të dhënat në lidhje me vendndodhjen e personit/subjektit;
- b) të dhënat/gjenealitetet e subjektit ndaj të cilit është vendosur masa shtrënguese ndërkombëtare.

6. Regjistri aksesohet nga:

- a) ministria, si administratore dhe përdoruese e regjistrit;
- b) organet përgjegjëse zbatuese, si lexuese të regjistrit;
- c) publiku, si lexues nëpërmjet ndërfaqes së ministrisë në internet dhe portalit qeveritar *e-Albania*.

6.1 Aksesimi në këto të dhëna rregullohet sipas legjislacionit për të drejtën e informimit dhe legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

IV. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Organet përgjegjëse, të përcaktuara në pikën 4, të nenit 10, të ligjit nr. 72/2019, i dërgojnë ministrisë pikat e kontaktit dhe funksionet e përfaqësuesve të Komitetit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

2. Ngarkohen organet përgjegjëse të përcaktuara në nenin 11, të ligjit nr. 72/2019, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama